



RËRUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Nr.558/ 579 regjistri, datë 20./ 24.3.2014.

Nr.5 vendimi, datë 13.1.2015.

V E N D I M
NË
“EMËR TË REPUBLIKËS”

Unë Ahmet JANGULLI/ GJYQTAR në gjykatën administrative të shkallës së parë Shkodër, në Shkodër në datën 13.1.2015, shqyrtova në seancë përgatitore çështjen administrative nr.558/ 579 akti, që u përket palëve :

Paditëse :

VLLAZNIMI DEDA IMPORT EKSPORT” sh.p.k., e identifikuar me Nipt in J78716319A, me seli Shkodër Pukë PUKË Shkozë komuna Gjegjan. Përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor Preng Deda.

Të paditur :

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër.

E përfaqësuar në gjykim/ me shkresën nr.2632 prot datë 10.4.2014, nga juristja Sirjana Bakushi/ e njohur me letërnjoftimin me nr.024589376 e me nr.personal H75426117F.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Drejtoria e Apelimit Tatimor) Tiranë.

Objekti :

Konstatimin nga gjykata të pavlefshmërisë absolute të njoftim vlerësimit nr.257/7 datë 28.2.2013 për 14.713.628 lekë të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër.

B. Ligjore :

Neni 116 dhe 117 e vijues i ligjit nr.8485 datë 12.5.1999 “Për procedurat administrative në RSH”. Neni 23, 32, 68, 69, 75, 83, 84, 106, 107, 108, 111, 114, 115 e vijues të ligjit nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat administrative në RSH” dhe Udhëzimit nr.24 datë 2.9.2008 lëshuar në zbatim të tij, neni 33, 50, 52 e vijues i ligjit nr.7928 datë datë 27.4.1995 “Për TVSH-në” dhe Udhëzimi nr.17 datë 13.5.2008 leshuar në zbatim të tij, etj.

Gjatë gjykimit, në mungesë të palëve, ku pala paditëse ka paraqitur një kërkesë me shkrim/ për heqje dorë nga gjykimi, e si shqyrtova aktet shkresore në tërësi.

KONSTATOVA

I.

1. Se, pala paditëse ka vënë në lëvizje gjykatën me padi/ duke pretenduar sipas objektit.

1.1. pala paditëse kërkimin e saj/ në datën 3.2.2014, e ka paraqitur para gjykatës së shkallës së parë Shkodër/ që ka regjistruar për gjykim çështjen civile nr.685 akti datë 6.2.2014, dhe për kërkimin e paraqitur gjykata e shkallës së parë Shkodër/ me vendimin civil nr.245 datë 21.2.2014 ka vendosur:

“1. Të deklarojë moskompetencën lëndore ...”

2. Dërgimin e akteve ... Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. ...”

1.1.1. Gjykata pa parashtruar rrethana fakti, *ose më saktë pa parashtruar ndonjë rrethanë fakti, më tepër se sa objekti i kërkesëpadisë*, në arsyetimin e saj/ ka arsyetuar se:

“lënda e gjykimit është në kompetencën lëndore të gjykatës administrative”/ dhe na i ka dërguar neve aktet.

II. Rrethanat e faktit :

2. Palët me njeri tjetrin, janë në një konflikt, për veprimet administrative të kryera gjatë mbajtjes së aktit administrativ.

2.1. pala paditëse ka vënë në lëvizje gjykatën me padi/ duke pretenduar sipas objektit të mësipërm, duke paraqitur para gjykatës/ padinë e mësipërme (padia e regjistruar/ si më sipër), dhe duke mos i bashkëngjitur asaj/ asnjë lloj akti (edhe ato akte shkresore që janë, në fashikullin e administruar nga gjykata e shkallës së parë Shkodër; janë akte shkresore që janë, në fashikullin e administruar nga gjykata e shkallës së parë Shkodër, në një çështje të pushuar më parë; aktet, në fashikull).

2.1.1. pala paditëse/ është paraqitur para gjykatës, duke kërkuar:

“Konstatimin nga gjykata të pavlefshmërisë absolute të njoftim vlerësimit nr.257/7 datë 28.2.2013 për 14.713.628 lekë të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër.” (**objekti i padisë**);

“Asnjë lloj kërkimi konkret” (**arsyetimi i padisë**);

dhe,

“Shfuqizimin e njoftim vlerësimit nr.257/7 datë 28.2.2013 për 14.713.628 lekë, si dokument absolutisht i pavlefshëm” (**kërkimi në fund të padisë**).

2.1.1.1. në kërkimin që trajton padia e mësipërme, me atë objekt padie, me parashtrimin në arsyetimin e saj, dhe me kërkimin e konkluduar që trajton padia, nuk mund të konceptohet se çfarë po kërkojnë paditësi, në raport me veprimet administrative të kryera nga pala e paditur, në raport me aktin administrativ objekt gjykimi, duke konsideruar ligjin

procedural (ligjin nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe k.pr.civile).

3. Çështja (padia) është paraqitur për gjykim në datën 20.3.2014. Në zbatim të ligjit procedural civil – administrativ/ gjykata ka vendosur që të regjistrohet padia e bashkë me regjistrimin të paguhet edhe taksa mbi aktet e shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.

4. Në datën 17.12.2014/ çështja ka kaluar për veprime përgatitore, duke thirrur edhe palët për t'i dëgjuar.

4.1. në seancë, është paraqitur av. Artan Reçi/ me nr. Leje 1374 e me nr. Nipt i K86325004M, për të përfaqësuar që gjykim palën paditëse, pa tagër përfaqësimi.

4.1.1. në seancë, palët e tjera ndërgjyqëse nuk u paraqiten/ pa ndonjë shkak të arsyeshëm, ndonëse kishin dijeni të rregullt, dhe në këto rrethana gjykimi u zhvillua në mungesë të tyre. *D.R. / 17.12.2014*

4.2. në veprimet përgatitore/ në seancën e datës 17.12.2014, kërkesëpadia i është kthyer palës paditëse për t'a plotësuar atë në elementët e saj të nevojshëm;

4.2.1. që kërkojnë nenet 154 e 156 të k.pr.civile, e konkretisht/ në lidhje me:

identifikimin e aktet identifikuar për palët ndërgjyqëse, adresën (vendbanimin ose vendqëndrimin) e palës paditëse, palës së paditur, dhe të personave që përkatesisht i përfaqësojnë ato, objektin, tregimin e fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese, të drejtën mbi të cilën mbështetet kërkimi, dhe kërkimin (*me fjalë të tjera, duhen identifikuar palët ndërgjyqëse, duhet përcaktuar adresa (vendbanimi ose vendqëndrimi) i palëve, dhe i personave që përkatesisht i përfaqësojnë ato, duhet përcaktuar objekti, duhet orientuar kërkimi, në mbështetje të shkakut ligjor, nëse jeni para këtij kërkimi, para kësaj ndërgjyqësie në kuptimin procedural e material, mënyra e kërkimit të së drejtës, duhet parashtruar fakti si për të drejtën tuaj ashtu dhe për të drejtën e shkelur nga ana e palës së paditur, dhe kërkimin e konkluduar*), dhe kopje të kërkesë padisë e të akteve provuese për të drejtën çfarë kërkohet, për palët e aktorët që marrin pjesë në çështje;


dhe,

4.2.2. që kërkon neni 21 i ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykin e mosmarrëveshjeve administrative”, e konkretisht/ në lidhje me:

adresën e paditësit ose të përfaqësuesit, në të cilën duhet t'i dërgohen nga gjykata njoftimet dhe aktet, e një numër telefoni të tij ose të përfaqësuesit, në të cilin gjykata mund ta njoftojë, një adresë elektronike të tij ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, si dhe deklaratën e pranimit të njoftimit me telefon ose në mënyrë elektronike;

sipas vendimit kthim për plotësim të datës 17.12.2014/ duke i lënë një afat kohor prej 3 ditësh, dhe për këtë arsy e ndërprenë veprimet përgatitore (për më shumë p-v, e vendimi kthim për plotësim).

5. Për vendimmarrjen e mësipërme, paditësi ka marrë dijeni në datën/ pa datë, dhe në datën 8.1.2015 (nëpërmjet kancelarisë), pala paditëse ka paraqitur një kërkesë me shkrim/ per heqje dorë nga gjykimi.



5.1. në rrethanat e mësipërme, në datën 13.1.2015, çështja ka kaluar përsëri për veprime përgatitore, pa i thirrur palët përfi dëgjuar.

III. Vlerësimi i gjyqtarit :

6. Në këto rrethana/ e çmova se, duhet vendosur pushimi i gjykimit të çështjes.

Sa sipër provohet me aktet shkresore dhe gjithë dokumentacioni në dosje.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 158 gëрма a § 1 e 9/ për nenin 299 gëрма b)/ për nenin 201 § 1 të k.pr.civile, dhe nenit 39 pika 3 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

V E N D O S A

Pushimin e gjykimit në çështjen administrative nr.558/ 579 akti, datë 20.3.2014, që është ngritur nga pala paditëse shoqëria VLLAZNIMI DEDA IMPORT EKSPORT” sh.p.k., për shkakun se hoqi dorë nga gjykimi.

Shpenzimet gjyqësore t'i ngarkohen palës paditëse shoqëria VLLAZNIMI DEDA IMPORT EKSPORT” sh.p.k..

Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë, në gjykatën administrative të apelit Tiranë.

U shpall në Shkodër me 13 janar 2015.


Shpenzime gjyqësore:

Njoftime


Akte – Letër

Shuma

Sekretare
Entela HASMUJAJ



GJYQTAR
Ahmet JANGULLI



VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË

SOT ME DATË 27.01.2015

KANCELARE

BLERTA NURJA

